

Statistikat e Krimeve

Tremujori i katërt 2017


Tiranë, më 29 Janar 2018: Statistikat e mëposhtme paraqesin të dhëna për vepra penale kryesore dhe autorë për kategori të veçanta të evidentuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Klasifikimi i tyre është realizuar sipas klasifikimit të ri ndërkombëtar të krimeve për qëllime statistikore.

Në tremujorin e katërt 2017 janë evidentuar 10 vrasje me dashje, duke shënuar një ulje me 41,2 %, krahasuar me tremujorin e katër 2016. Në këtë grup bëjnë pjesë të gjitha ato vepra penale kundër jetës të kryera me dashje. Në vitin 2017 janë evidentuar 50 vrasje me dashje, me një rënie prej 29,6 %, krahasuar me vitin 2016.

Numri i veprave penale të rënda kundër pasurisë në tremujorin e katërt 2017 është 44, dhe u rrit me 2,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërkohë, për këtë kategori, në vitin 2017 janë evidentuar 183 vepra penale, duke shënuar një rritje me 15,1 %, krahasuar me 2016.

Në tremujorin e katërt 2017 janë evidentuar 21 krime seksuale, duke shënuar një ulje me 41,7 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2016. Në vitin 2017 janë evidentuar 113 krime seksuale, duke shënuar një rënie me 5,8 %, krahasuar me vitin 2016.

Fig. 1 Ndryshimi në përqindje sipas veprave, T4 - 2017 dhe T4 - 2016



Numri i veprave penale të evidentuara për krime kundër shëndetit, në tremujorin e katërt 2017, është 35, me një rritje prej 52,2 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2016. Këtu bëjnë pjesë ato vepra që

synojnë t'i shkaktojnë lëndime të rënda trupore një personi. Në vitin 2017 janë evidentuar 137 krime kundër shëndetit, duke shënuar një rritje me 14,2 %, krahasuar me vitin 2016.

Në tremujorin e katërt 2017 janë evidentuar 454 vepra penale në fushën e drogës, duke shënuar një rënie me 27,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016. Ndërkohë në vitin 2017 janë evidentuar 2.120 krime në fushën e drogës, duke shënuar një rënie me 35,2 %, krahasuar me vitin 2016.

Në tremujorin e katërt 2017 janë evidentuar 1.432 vjedhje të pasurisë, me një rritje 19,1 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2017. Në këto vepra bëjnë pjesë të gjitha ato vepra që synojnë përfitimin e pasurisë së tjetrit në mënyrë të padrejtë si vjedhje automjetesh, vjedhje kompanie, lokale tregtie etj. Në vitin 2017 janë evidentuar 5.096 vjedhje të pasurisë, duke shënuar një rënie me 9,6 %, krahasuar me vitin 2016.

Numri i veprave penale të evidentuara për vjedhje banese, në tremujorin e katërt 2017, është 300, duke shënuar një rritje me 15,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në vitin 2017 janë evidentuar 1.145 vjedhje banese, duke shënuar një rënie me 5,8 %, krahasuar me 2016.

Tab. 1 Vepra penale të evidentuara

Vepra penale të evidentuara	2016	2017	Ndryshimi vjetor në %	T4 - 2016	T 4 - 2017	Ndryshimi tremujor në %
Vrasje	71	50	-29,6	17	10	-41,2
Vepra penale të rënda kundër pasurisë	159	183	15,1	43	44	2,3
Krime seksuale	120	113	-5,8	36	21	-41,7
Krime kundër shëndetit	120	137	14,2	23	35	52,2
Krime në fushën e drogës	3.274	2.12	-35,2	628	454	-27,7
Vjedhje e pasurisë	5.637	5.096	-9,6	1.202	1.432	19,1
Vjedhje banese	1.216	1.145	-5,8	259	300	15,8

Autorët e veprave penale

Në tremujorin e katërt 2017 janë regjistruar 10 autorë për vrasje me dashje, duke shënuar një rënie me 41,2 %, krahasuar me tremujorin e katërt të 2016. Në vitin 2017 janë regjistruar 48 autorë për vrasje me dashje, duke shënuar një rritje me 40,0 %, krahasuar me vitin e mëparshëm.

Numri i autorëve për vepra penale të rënda kundër pasurisë në tremujorin e katërt 2017 është 44, duke shënuar një rritje me 15,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërkohë, për të njëjtën vepër penale, në vitin 2017, janë regjistruar 202 autorë, duke shënuar një rritje me 1,5 %, krahasuar me vitin 2016.

Në tremujorin e katërt 2017, janë regjistruar 24 autorë për veprën krime seksuale, duke shënuar një rënie me 42,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në vitin 2017 janë regjistruar 111 autorë për veprën krime seksuale, duke shënuar një rënie me 12,6 %, krahasuar me vitin 2016.

Për veprën krime kundër shëndetit, në tremujorin e katërt 2017 janë regjistruar 35 autorë, duke shënuar një rritje me 20,7 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2016. Krahasuar me 2017 janë regjistruar 156 autorë për veprën krime kundër shëndetit, me një rënie me 5,5 %, krahasuar me 2016.

Numri i autorëve për krime në fushën e drogës, në tremujorin e katërt 2017, është 574, duke shënuar një rënie me 24,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërkohë për të njëjtën vepër numri i autorëve për vitin 2017 është 2.541, duke shënuar një rritje me 0,3 %, krahasuar me vitin 2016.

Për veprën vjedhje e pasurisë, në tremujorin e katërt 2017 janë regjistruar 865 autorë, duke shënuar një rritje me 8,7 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2016. Viti 2017 shënon 3.668 autorë për veprën vjedhje e pasurisë, me një rënie me 16,7 %, krahasuar me 2016.

Numri i autorëve për vjedhje banese në tremujorin e katërt 2017 është 121, duke shënuar një rënie me 14,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërkohë në vitin 2017 janë regjistruar 628 autorë për të njëjtën vepër, duke shënuar një ulje me 23,8 %, krahasuar me vitin 2016.

Tab. 2 Autorë të veprave penale

Vepra penale	2016	2017	Ndryshimi vjetor në %	T4-2016	T4-2017	Ndryshimi tremujor në %
Vrasje	80	48	-40,0	17	10	-41,2
Vepra penale të rënda kundër pasurisë	199	202	1,5	38	44	15,8
Krime seksuale	127	111	-12,6	42	24	-42,9
Krime kundër shëndetit	165	156	-5,5	29	35	20,7
Krime në fushën e drogës	2.534	2.541	0,3	756	574	-24,1
Vjedhje e pasurisë	4.402	3.668	-16,7	796	865	8,7
Vjedhje banese	824	628	-23,8	141	121	-14,2

Metodologjia

Statistikat e krimeve pasqyrojnë të dhëna mbi veprat penale të evidentuara dhe personat e dyshuar si autorë në kryerjen e një veprë penale. Grupimi i veprave penale është bërë sipas Klasifikimit të ri ndërkombëtar të krimeve për qëllime statistikore.

Të dhënat mbi veprat penale të evidentuara i referohen artikujve të Kodit Penal dhe jo ngjarjes, pasi në një ngjarje mund të kemi më shumë se një vepër penale.

Të dhënat mbi autorët bazohen në persona të dyshuar në kryerjen e një veprë penale, jo në gjykime përfundimtare, të cilat janë në kompetencat e organeve të drejtësisë për të dhënë verdiktin.

Përkufizime:

Vepra penale: Veprat me të cilat cënohen, dëmtohen vlerat juridike të njeriut dhe të bashkësisë së caktuar quhen vepra penale apo me një term të përgjithshëm kriminalitet. Ato ndahen në krime dhe kundravajtje penale.

Autorë: Persona të cilët me veprimin ose mosveprimin e tyre lejon që të ndodh një vepër penale pra shkakton pasojën e veprës penale. Autorët mbi 14 vjeç kanë përgjegjësi penale ndërkohë fëmijët nën 14 vjeç janë të përjashtuar nga përgjegjësia penale.

Vrasje me dashje: Përfshihen ato vepra penale kundër jetës të kryera me dashje si vrasje me dashje, vrasje me paramendim, vrasje për gjakmarrje, vrasje në rrethana të tjera cilësuese.

Vepra penale të rënda kundër pasurisë: Përfshihen ato vepra që synojnë vjedhjen e një personi duke përdorur dhunë apo forcë, si vjedhje me dhunë, vjedhje me armë dhe vjedhje me pasojë vdekjeje.

Krime seksuale: Përfshihen ato vepra të kundraligjshme që ndikojnë në sferën e sigurisë së lirisë seksuale dhe të zhvillimit normal të formimit seksual.

Krime kundër shëndetit: Përfshihen ato vepra që synojnë të shkaktojnë lëndime dhe plagë të rënda të një personi, si plagosje e rëndë me dashje, tortura me pasoja të rënda etj.

Krime në fushën e drogës: Përfshihen vepra si prodhimi dhe shitja e narkotikëve, kultivimi i bimëve narkotike, trafikimi i narkotikëve etj.

Vjedhje pasurisë: Përfshihen ato vepra që synojnë përfitimin e pasurisë së tjetrit në mënyrë të padrejtë si vjedhje automjetesh, vjedhje kompanie, lokale tregtie, vjedhje energjie elektrike, vjedhje e bankave dhe arkave të kursimit.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Të dhënat mbi veprat penale të evidentuara dhe autorët janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.